



Datë: 03.03.2025

Numër Protokolli: 1426/2025

A.nr.02/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.02/2025, të datës 03.01.2025, të parashtruar nga ankuesja K.S, organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 03.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.02/2025, e datës 03.01.2025, e parashtruar nga ankuesja, K.S.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 3410 i datës 30.12.2024, Vendimi me numër protokolli 17 i datës 08.01.2025 si dhe Vendimi me numër protokolli 62 i datës 13.01.2025 .

III. Obligohet Zëvendës Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta kthej ankuesen në vendin e saj të punës sipas Akt emërimit me numër protokolli 72/2018 të datës 03.12.2018, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, K.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), e punësuar në Inspektoratin e Punës, më datë 03.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 02/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.02/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 3410, të datës 30.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, mbi të cilin vendim ankueses i është shqiptuar masa disiplinore “*transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*”, gjegjësisht e njëjta është transferuar nga pozita e Zyrtares së Lartë të Personelit-Divizioni i Burimeve Njerëzore, në kuadër të Divizionit të Arkivës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa ky i fundit me datë 16.01.2025 përmes Menaxherit të Personelit z. F.K, ka dorëzuar përgjigjën me provat e bashkangjitura të lëndës, dhe se po ashtu me datë 23.01.2025, z. N. Sh ka dorëzuar një përgjigje tjetër me provat e bashkangjitura të lëndës.

Ndërsa, Kryetari i Këshillit, duke vepruar sipas kërkesës së datës 14.02.2025 së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1073/2025 të datës 18.02.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.02/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 02/2025, të datës 03.01.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Vendimin me numër protokolli 3410 të datës 30.12.2024; Kërkesën me numër protokolli 3048 të datës 18.11.2024; Vendimin me numër protokolli 2527 të datës 27.10.2023; Vendimin me numër protokolli 2322 të datës 26.09.2023; Njoftimin me e-mailin e datës 27.10.2023; Shkresat e ankueses për Komisionin Disiplinor; Plotësimin e ankesës së datës 08.01.2025; Vendimin me numër protokolli 17 të datës 08.01.2025; Raportin nga konsulta mjekësore me numër protokolli 1276 të datës 11.02.2025, të lëshuar nga ASKP në SHSKUK; Raportin nga konsulta mjekësore me numër protokolli 87 të datës 12.01.2025, të lëshuar nga APKP në SHSKUK; Raportin nga konsulta mjekësore të datës 03.01.2025, të lëshuar nga QKMF-Hajvali; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 27.01.2025, të lëshuar nga QKMF-Hajvali; Thirrjen e urgjencës mjekësore me numër 1316 të datës 28.01.2025; Raportin mjekësor të datës 15.01.2025 të lëshuar nga QKMF-Hajvali; Raportin mjekësor të datës 27.01.2025, të lëshuar nga QKMF-Hajvali; Kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshillit; Përgjigjen në ankesë të datës 16.01.2025; Akt emërimit me numër protokolli 72/2018 të datës 03.12.2018; Përshekrimin e detyrave të punës 167/22 të datës 24.06.2022; Formularët e rezultateve të punës të ankueses; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër protokolli 3048 të datës 18.11.2024; E-mailin e datës 05.12.2024; E-mailin e datës 10.12.2024; Akt emërimit me numër protokolli 36 të datës 07.02.2012; Akt emërimit AE.Nr.183/2023 të datës 08.09.2023; Vendimin me numër protokolli 3238 të datës 09.12.2024; Përgjigjen në ankesë të datës 23.01.2023; Vendimin me numër protokolli 3942 të datës 08.11.2024; E-mailin e datës 12.11.2024; Vendimin me numër protokolli 62 të datës 13.01.2025; Akt emërimit AE.Nr.183/2023 të datës 08.09.2023.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e bazuar, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 72/2018 të datës 03.12.2018, është emëruar në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Personel* në kuadër të Inspektoratit të Punës.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedhë se z. N. Sh, pas pranimit të shkresës elektronike të datës 12.11.2024 dhe atë të datës 07.11.2024 të parashtruar nga z. H.N, përmes shkresës me numër protokolli 3048 të datës 18.11.2024, duke u bazuar në nenin 59 paragrafi dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenin 6 paragrafi nën paragrafi 4.1 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil,

ka parashtuar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuses nën supozimin për tejkalim të kompetencave apo për shkelje të rëndë të detyrave të punës, duke kështu shkaktuar pasoja juridike.

Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me Vendimin me numër protokolli 3410, të datës 30.12.2024, ka konstatuar se ankuesja me veprimet e saj është përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore si veprime që kanë shkaktuar pasoja juridike, dhe rrjedhimisht të njëjtës i shqipton masën disiplinore “*transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*”, nga pozita aktuale e *Zyrtares së Lartë të Personelit*-Divizioni i Burimeve Njerëzore, në kuadër të *Divizionit të Arkivës*, sikurse përcaktohet me nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë.

Ankuesja, kundër Vendimit me numër protokolli 3410, të datës 30.12.2024, brenda afatit ligjor ka parashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se akti kontestuar me ankesë është nxjerrë përmes vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, duke theksuar ndër të tjera se : veprimi i saj i cili supozohet se shkelja e rëndë e detyrave të punës, në fakt është një detyrim ligjor i përcaktuar nga neni 130 paragrafi 1 dhe neni 143 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; transferimi im është i qëllimshëm ngase Komisioni ka vendosur të transferohet në një pozitë të pa qenë; Komisioni nuk ka qenë në harmoni me rregulloren përkatëse sepse anëtarja e këtij komisioni, nuk është zyrtare e IP-së; z. H.N nuk ka kompetencë të veprojë për shkak të emërimit të kundër ligjshëm të vërtetuar nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme; z. N. Sh nuk është menaxher i personelit sepse kjo pozitë nuk është pozitë e lirë, dhe se nuk mund të ketë U.D për një rast të tillë e që mbi të gjitha vendimin për caktimin e tij e ka marr z. H.N i cili nuk ka kompetencë të veproj dhe si i tillë ky iniciim është në kundërshtim me nenin 52 të LPPA-së, rrjedhimisht i ka propozuar Këshillit që të aprovohet si e bazuar ankesa, të anulohet akti kontestues dhe e njëjta të kthehet në pozitën e *Zyrtares së Lartë të Personelit*.

Ndërsa, më datë 08.01.2025 ankuesja ka bërë plotësimin e ankesës duke bashkangjitur kështu Vendimin me numër protokolli 17 të datës 08.01.2025, mbi të cilin vendim Komisioni Disiplinor, ka korrigjuar vendimin paraprak duke transferuar ankuesen tani më në pozitën *Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional* në kuadër të *Divizionit Ligjor*, mirëpo ankuesja pretendon se me këtë rast Komisioni ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 të LPPA-së, ngase nuk ka korrigjuar por edhe ka ndryshuar përmbajtjen e aktit kontestues, dhe se me datë 11.02.2024 ka bashkangjitur raporte mbi kontrollet mjekësore të lëshuara nga institucionet publike shëndetësore të Republikës së Kosovës.

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit, fillimisht sjellë në vëmendje se Komisioni Disiplinor Vendimin me numër protokolli 3410, të datës 30.12.2024, nga i cili ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore “*transferim në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*”, nga pozita aktuale e *Zyrtares së Lartë të Personelit*-Divizioni i Burimeve Njerëzore, në kuadër të *Divizionit të Arkivës*, e ka korrigjuar me Vendimin me numër protokolli 17 të datës 08.01.2025, duke transferuar ankuesen në pozitën *Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional* në kuadër të *Divizionit Ligjor*, ndërsa nga përgjigja tjetër në ankesë e datës 23.01.2025, rezulton se vendimi i sapo theksuar është korrigjuar përsëri, dhe se tani më sipas Vendimit me numër protokolli 62 të datës 13.01.2025, Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës, ankuesen e ka transferuar në pozitën *Zyrtare e Lartë Ligjore* .

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuses dhe shkresat e ofruara të lëndës, konstaton se e tërë procedura disiplinore që nga iniciimi i saj dhe deri tek nxjerrja e tani më tri Vendimeve kontestuese është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore procedurale dhe materiale, e që si rezultat i tyre nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe juridike, ngase fillimisht duke u bazuar në arsyetimin e Vendimit A.nr.1571/2024, të Këshillit të datës 29.11.2024, sipas të cilit arsyetim të gjitha

instancat gjyqësore të Republikës së Kosovës, kanë vërtetuar Vendimin Nr.50/2022 të Këshillit, sipas të cilit konstatohet se emërimi i z. H.N në pozitën e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, është i kundërligjshëm dhe shkel rëndë parimet e pranimit të zyrtarëve publik, thënë më konkretisht nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023 është refuzuar padia e palës paditëse-Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, nga Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër AA.nr.354/2023 të datës 08.07.2024 është refuzuar ankesën e palës së njëjtë paditëse si dhe po ashtu përmes Aktvendimit me numër ARJ.nr.134/2024 të datës 25.09.2024 Gjykata Supreme e Kosovës e ka hedhur kërkesën e paditëse. Andaj, i njëjti në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk ka mandat ligjor dhe autorizim ligjor për ushtrimin e kësaj pozite të kategorisë së lartë drejtuese, rrjedhimisht në rastin konkret as parashtrimin të njoftimit/kërkesës për ndërmarrjen e veprime disiplinore ndaj ankueses, sikurse në rastin përkatës përmes shkresës elektronike të datës 07.11.2024.

Tutje, Kolegji i Këshillit, konstaton se as z. N. Sh në kuptim të nenit 59 paragrafi dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenin 6 paragrafi nën paragrafi 4.1 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, nuk ka mandat ligjor për iniciimin e kërkesës disiplinore ndaj ankueses, për faktin e pa kontestueshëm se i njëjti nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses, ngase i njëjti kundër ligjshëm përmes Vendimit me numër protokolli 2942 të datës 08.11.2024, ishte caktuar nga z. H.N dhe atë në pozitën e z. F.K atë të *Menaxherit të Personelit*, mirëpo Këshilli përmes Vendimit A.nr.1571/2024 e kishte shfuqizuar si të paligjshëm vendimin për transferimin e z. F.K në pozitën e *Udhëheqësit të Divizionit për Arkivë*, duke kthyer këtë të fundit në vendin e punës atë *Menaxherit të Personelit* sipas Akt emërimit me numër protokolli 02/2021 të datës 19.04.2021.

Mirëpo, pavarësisht jo kompetencës dhe autorizimit ligjor për emërimin e tij nga z. H.N në këtë pozitë e cila faktikisht nuk ka qenë pozitë e lirë në mënyrë që të caktohet Ushtrues Detyre, dhe se për më tepër vlen të theksohet se ky veprim është në kundërshtim edhe me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *‘1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit’*, sepse z. N. Sh sipas Akt emërimit AE.Nr.363/2022 të datës 01.12.2022, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar i të Hyrave dhe i Zotimeve*, Kategoria Profesional 2, ndaj i njëjti në këtë kuptim nuk mund të caktohet nga kjo kategori profesionale në Kategorinë e Ulët Drejtuese, ngase në rast të ekzistimit si pozitë e lirë duhej të caktohej një zyrtar të lartë nga kategoria pasuese, apo thënë më konkretisht një zyrtarë që mbanë pozitën e Kategorisë Profesional 1 me Akt emërim, nga cilado njësi organizative brenda Inspektoratit të Punës.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës po ashtu konstaton se edhe Vendimi me numër 3238 i datës 09.12.2024, për plotësim ndryshimin e Vendimit me numër protokolli 3048 të datës 27.12.2023 për përbërjen e Komisionit Disiplinor, është i pa ligjshëm ngase i njëjti është nxjerrë nga z. H.N, e që përpiluesi i këtij akti tani nga të gjitha instancat gjyqësore të Republikës së Kosovës është vërtetuar se nuk ka mandat dhe autorizim ligjor për ushtrimin e kësaj pozitë, duke kështu vepruar në kundërshtim edhe me parimin e ligjshmërisë apo me nenin 4 të LPPA-së dhe me paragrafin 1 të nenit 60 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *1. Në çdo institucion publik themelohet komisioni disiplinor me mandat dy (2) vjeçar, që themelohet nga drejtuesja/i i lartë i institucionit, dhe se po ashtu pavarësisht kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se përbërja e Komisionit Disiplinor, është në kundërshtim edhe me paragrafin 3 të këtij neni, i cili përcakton se: 3. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtare/ë që përfshin një (1) përfaqësuese/es të NjMBNj-së të institucionit përkatës dhe në*

përbërje të komisionit disiplinor duhet të jetë së paku një (1) juriste/st; ngase faktikisht znj. R.M e caktuar anëtare sipas këtij Vendimi, nuk është përfaqësuese e NJMBNJ-së së Inspektoratit të Punës, mirëpo e njëjta sipas Akt emërimit me numër protokolli 2458/2024 të datës 25.09.2024, është punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Andaj, në bazë të konstatimeve si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se iniciuesit e kësaj procedure disiplinore si dhe Komision Disiplinor nuk ka mandat dhe autoritet ligjorë për kryerjen e procedurave disiplinore dhe për të nxjerrë vendime mbi shqiptimin e masave disiplinore, ashtu që me këtë rast akti i kontestuar me ankesë dhe aktet tjera korrigjuese, gjegjësisht Vendimi me numër protokolli 3410, të datës 30.12.2024, i korrigjuar me Vendimin me numër protokolli 17 të datës 08.01.2025 si dhe më pas Vendimi me numër protokolli 62 të datës 13.01.2025, mbi korrigjimin e vendimit paraprak i Komisioni Disiplinor, janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 4, nenin 50 të Ligjit Nr.05-L/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.08-L/197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil dhe si të tilla konsiderohen të paligjshme në kuptim të nenit 52 të LPPA-së, si rrjedhojë e konstatimit se akti administrativ i shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuses është i paligjshëm për shkak të shkeljeve të ligjore të një pas njëshme të lartë theksuara, Kolegji i Këshillit nuk u lëshua në trajtimin e pretendimeve tjera ankimore të ankuses, ngase të njëjtat nuk do të kishin ndikim për vendosje ndryshe për çështjen përkatëse.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj ankesën si të bazuar, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të Vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.02/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, K.S;*
- *Zëvendës Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*